



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 05.07.2024

Nr: 69

Ora: 10:30

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E VLEFSHMËRISË SË MANDATIT TË KRYETARIT TË BASHKISË
HIMARË, Z. DHIONISIOS (ALFRED) PETRO BELERI, PROPOZUAR NGA
SUBJEKTI ZGJEDHOR KOALICIONI “BASHKË FITOJMË”, PËR ZGJEDHJET
PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot në datën 05.07.2024, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Palë të interesuara: 1). Z. Eugen Likaj, lindur ne Borsh, Sarandë, më datë 19.09.1987, me nr letër njoftimi 032574030.

2). Z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, kryetar i Bashkisë Himarë, qarku Vlorë, i propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 90 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, nenin 10, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

Z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, është propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, si kandidat për Kryetar të Bashkisë Himarë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe Kryetari i Bashkisë.

Në datën 31.03.2023, pranë KQZ nga z. Beleri është depozituar formulari e vetëdeklarimit, i cili është regjistruar me numër unik VL-BF-13387.

Në bazë Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, KQZ-ja bëri verifikimin “*prima facie*” të të dhënave që përmban ky formular dhe konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit.

Në vijim KQZ ndërmori hapat e mëposhtëm:

1. Nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, në datën 04.04.2023 i kërkoi informacion zyrës së gjendjes civile pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila nga ana e saj informon KQZ se subjekti vetëdeklarues z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, rezulton të ketë ndryshuar emrin nga “Alfred” në “Dhionisios”.

2. Nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, në datën 05.04.2024, KQZ i kërkoi informacion zyres së gjendjes gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se subjekti vetëdeklarues z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, rezultoi i rehabilituar.

Në përfundim të procesit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 611, datë 25.05.2023, i ka dhënë mandatin z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, si Kryetar i Bashkisë Himarë.

Pasi është konstatuar që kandidati nuk është në kushtet e ndalimit për të kandiduar, janë verifikuar të dhëna të tjera në formularin e vetëdeklarimit të z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, ku rezultoi se ka deklaruar:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se ka bërë ndryshim në gjeneralitetet e tij. Ka ndryshuar emrin nga “Alfred” në “Dhionisios”.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 1 “A jeni dënuar ndonjë here me vendim gjyqësor të formës së prerë”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”.
'Dënuar nga Gjykata e Apelit, Athinë, me vendim gjyqësor të formës së prerë, me Nr.752 në vitin 1999, me 18 muaj burgim me 3 vjet kusht, për kryerjen e veprës penale, dijani (Bashkëpunim) për veprën penale të mbajtjes së armëve pa leje, nga personi i tretë. (Nenet të legjislacionit grek 1244/1972, 2168/1993, 1780/1988, 652/1977). Për të cilën deklaroi se nuk ka kryer asnjë ditë burg.'
- Pyetjes 3 - “A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoriteti i huaj, për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”.
'Dijani (Bashkëpunim) në mbajtje arme pa leje nga personi i tretë, nga Prokuroria, Athinë me 18 muaj burg me 3 vjet kusht, për periudhën 1995-1996.'
- Pyetjes 4 - “A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues i është përgjigjur “PO”.
'I vit paraburgim, për periudhën 24.03.1995 - 24.03.1996 nga Prokuroria Athinë. (HETIME), 1 ditë ndalim për verifikim dokumentacioni, në datën 13.04.1999, nga Policia Kufitare, Aeroporti Athinë.'
- Pyetjes 5 - “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”.

'Paraburgim për periudhën 24.03.1995 deri më 24.03.1996 nga të cilat 3 muaj të kryera në Janinë për shkak se është bërë ndalimi, për vepren penale, dijani (Bashkëpunim) në mbajtje arme pa leje nga personi i tretë, nga Gjykata e Apelit, Athinë. (Nenet të legjislacionit grek 1244/1972, 2168/1993, 1780/1988, 652/1977).'

- Pyetjes 8 - “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”

'Ka deklaruar se ka jetuar në Greqi, Zakynthos për arsye emigracioni, në periudhën 1990-1993, në Qipro në periudhën janar 1994 -korrik 1994, 1994-2014 në Greqi.'

Nga konstatimet e mësipërme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4099 prot., datë 24.04.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra. Prokuroria e Përgjithshme nuk ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit.

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa me nr. 1719 prot., datë 26.06.2023 nga z. Eugen Likaj nëpërmjet të cilës kërkohet konstatimi i përfundimit të parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1736 prot., datë 27.06.2023 i ka kërkuar informacion/dokumentacion Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nëse është marrë ndonjë vendim penal në ngarkim të shtetasit z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri.

Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me shkresën nr.933/1 prot, datë 1.7.2024, ka dërguar në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shkurtimin e vendimit nr. 26, datë 25.06.2024, dhënë në ngarkimi të të pandehurve Pandeli Kokoveshi dhe Dhionisios (Alfred) Petro Beleri.

KQZ me shkresën nr.1785 prot, 1.07.2024 i ka kërkuar informacion zyrës së gjendjes gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në lidhje me z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri.

Në përgjigje të kësaj kërkesë zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar dëshminë e penaltetit, në të cilën pasqyrohet vendimi me nr. 26, datë 25.06.2024 Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe

Krimin e Organizuar, e cila ka lënë në fuqi vendimin nr 14, datë 05.03.2024, të dhënë nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Përfaqësuesja ligjore e z. Beleri në shqyrtimin administrativ pretendoi:

'Nga këndvështrimi procedural, mendoj se procedura e ndjekur nga KQZ është e paqartë. KQZ nuk mund vihet në lëvizje nga një individ, pasi është në kundërshtim me nenit 7 të ligjit 138/2015 dhe mund të bëhet vetëm në rastet e përcaktuar në ligj. KQZ mund të vihet në lëvizje nga një individ i vetëm vetëm në periudhë zgjedhore dhe ne nuk jemi ne një periudhë zgjedhore.

Sipas ligjit 138/2015 neni 2 parashikohen ndalimi për t'u zgjedhur në një funksion publik dhe ne nuk jemi në këtë fazë, pasi z. Beleri tashmë është zgjedhur Kryetar i Bashkisë Himarë. Në nenin 10 të ligjit 138/2015 që vjen pas nenit 5 e vijues, duhet të interpretohej në tërësi që nga qëllimi i ligjit e deri tek procedura e ndjekur. Në të gjithë përmbajtjen e ligjit shqyrtohet vetëm mbi bazën e të dhënave të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit. KQZ nuk mund të marrë në këto momente vendim, KQZ nuk ka kompetencë për të marrë këtë iniciativë në këtë fazë, kur shtetasi Dhionisios (Alfred) Petro Beleri e ka marrë këtë mandat.

Sipas Ligjit 138/2015, KQZ duhet të marrë në konsideratë vetëm çfarë është deklaruar në FVD dhe asnjë e dhënë jashtë FVD nuk mund të merret në konsideratë në këtë moment. KQZ duhet të pushojë procedurën administrateve të iniciuar, pasi organi administrativ ka tejkuluar kompetencat që i njeh shprehimisht ligji.'

Përfaqësuesi i Partisë Socialiste, z. Eridian Saljani pretendoi se në interpretim të ligjit 138/2015, KQZ ka gjithë legjitimitetin për ta shqyrtuar këtë proces administrativ. KQZ ka gjithë të drejtën të ndërpresë mandatin e z. Beleri. *'Ky është një proces automatik përderisa kemi një vendim penal të Gjykatës së Apelit, këtu jemi vetëm për konstatimin e një fakti, a ka vendim Gjykata e Apelit apo jo. Vetë ligji i ka dhënë të drejtë KQZ të shpallë pavlefshmërinë e mandatit dhe të njoftojë organet kompetente. Ketu duhet të diskutojmë a jemi subjekt i ligjit të dekriminalizimit, kjo është e vetmja pyetje që do të kisha për palën. Nëse jemi subjekt i ketij ligji unë kërkoj që ju Kryetar të merrni vendimin dhe të mbyllim procedurë.'*

Përfaqësuesi i subjektit zgjedhor koalicionit “Bashkë Fitojmë”, z. Ivi Kaso pretendoi:

'Në lidhje me pretendimin e kolegut, pasi është tek relacioni i KQZ kjo pjesë, në lidhje me përgjigjen, duke folur si subjekte lidhur dhe me komentet, dua të them se ka një konfuzion që është ligji 138 2015 - Ligji i Dekriminalizimit dhe ligji 139 që është ai për organet e qeverisjes vendore. Bëri pyetje kolegu, a është subjekt i ligjit të dekriminalizimit. Komisioneri duhet vetëm

të pyesë a ka patur fshehje në formularin e dekriminalizimit dhe jo nuk është fshehur asgjë. Nëse del një fakt që nuk është paraqitur në formularin e dekriminalizimit, atëherë ndërhyr KQZ. Në këtë rast dhe në këtë hipotezë kërkoj të aplikohet neni 62 i ligjit 139 dhe jo neni 10 i ligjit 138 i vitit 2015.'

Përfaqësuesi i palës së interesuar z.Vangjel Dule pretendoi :

'Në respekt të prezantimeve të juristëve do të dëshiroja të theksoja që në fillim, se sot jemi përpara një tentative për te përmbyllur një përpara një tentave për të përmbyllur një proces politik i cili ka nisur në 6 Maj 2023. Kjo nisi me një autorsi, ku Kasa me te drejta tha që këtij procesi kërkohet ti fshihet fytura dhe ti falet tjetër kujt autorësia. Në këtë periudhe 14 mujore do të mund të rendisja 10 nenet duke filluar, nga Konventa Erupiane , Kodit Zgjedhore , ligji për partitë politike dhe keshtu me radhë. Perkufizohem vetëm në disa pretendime tonat, Belerit i është privuar e drejta, në datë 14 Maj nuk i është dhënë e drejta e votës për të shprehur vullnetin e tij, në datë 14 Maj. Nuk i është dhënë kjo e drejtë, pra as nuk ka votuar z.Beleri. i është privuar e drejta të zgjidhet, nuk është përmbushur detyrimi kushtetues për të marrë përsipër detyrën që i ka ngarkuar sovranit. I janë privuar të drejtat të zgjidhet dhe zgjedhë. Bashkia e Himarës drejtohet në mënyrë abuzive. Kemi të bëjmë me një zinxhir shkeljesh të ndryshme. Z.Beleri është arrestuar me pretendimin e flagrancës, ku në të vërtetë nuk ka pasur. Ishte me avokatin e tij dhe me të afërmin e vet.

Z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri pretendoi:

'Duket qartë se nuk ka bazë ligjore për gjykimin tim në ditën e sotme. Ata që vendosën vendimin e Himarës për mua, kanë gabuar. Do t'ju lutesha për të zgjidhur këtë punë njëherë e mirë se duket qartë se është bërë rrugë dhe jam dakord me përfaqësuesit e mi ligjorë.'

Pretendimet e përfaqësuesve të z. Beleri nuk qëndrojnë.

Duke referuar në interpretimin teleologjik të së drejtës, e konkretisht të ligjit nr 138/2015, synohet të gjendet qëllimi i gjithanshëm ligjit. Ligji 138/2015 ka si qëllim "...të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar...".

Në nenin 10, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 138/2015, përcaktohet se KQZ "...shpall pavlefshmërinë e mandatit kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe para fillimit të

ushtrimit të mandatit nga personi i shpallur i zgjedhur në kundërshtim me këtë nen, si dhe shpall mandatin, në përputhje me Kodin Zgjedhor...”;

Sipas përcaktimit të këtij neni, KQZ është organi kompetent për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të një kryetari bashkie.

Ligji për Dekriminalizimin e ndalon një person të kandidojë kur verifikohet që ai/ajo ka kryer një nga veprat penale të listuara në këtë ligj.

Ky ligj, apo më mirë të themi bazuar në këtë ligj një personi i hiqet mandati i fituar (si deputet, kryetar bashkie, anëtarë këshilli bashkiak, apo ministër jo deputet) kur pas marrjes së këtij mandati, apo pas fillimit të ushtrimit të detyrës së ministrit, verifikohet se ai/ajo ka kryer një nga veprat penale të listuara nga ligji i dekriminalizimit.

Sikurse referuam më sipër përfaqësuesja e z. Beleri pretendon se nëse gjatë ushtrimit të mandatit ai/ajo kryen një nga veprat penale të listuara në ligjin për dekriminalizimin, personi në fjalë nuk e humbet mandatin.

Ky pretendim vjen në kundërshtim me vetë thelbin e ligjit për dekriminalizimin dhe nuk mbështetet në një interpretim logjik të ligjit në tërësi.

Kur ky ligj të ndalon të kandidosh nëse ti je në kushtet e kryerjes dhe të dënimit për një vepër penale të caktuar, pra të ndalon edhe të pretendosh për të marrë një funksion publik, si mundet të të lejojë ky ligj që ta mbash këtë funksion publik, pasi e ke marrë atë dhe gjatë ushtrimit të tij ti kryen një vepër penale dhe merr një dënim i cili as nuk do të lejonte të kandidojë!

Pra për të njëjtin dënim një person nuk mundet të jetë i denjë për të kandiduar, por është i denjë për të qëndruar në detyrë?! Ky interpretim logjik i përmbajtjes tërësore të ligjit nr. 138/2015 bazohet edhe në përmbajtjen e nenit 1 të ligjit në fjalë.

Sipas kësaj përmbajtje është e qartë që në kushte ta caktuara, jo vetëm nuk mund të kandidosh për të marrë një mandat/funksion publik, por ti e humbet këtë mandat/funksion.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 90 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i

Procedurave Administrative”, nenin 10, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI